



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.125/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së tendës në hapsirë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 30.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë me Anr. 125/2019 e datës, 28.09.2019, dhe subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në shumë prej 6,200.00 (gjashtë mijë e dyqind) euro, cilën gjorbë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi nën **kërcënim të përmbarimit**.

II. Urdhërohet subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), që brenda afatit prej 24 orëve nga pranimi i këtij vendimi, që ta përmirësoj shkeljet e përcaktuar si në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.

A r s y e t i m

Me datën 28.09.2019, Lëvizja Vetëvendosje ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 28 Shtator 2019 rreth orës 13:30, në rrugën “Dardania” afër restaurantit “Mrika” në qytetin e Fushë Kosovës, kanë vërejtur se Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka vendosur “TENDË”, dhe disa postera të një kandidati për deputet nga radhët e PDK-së, në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së dhe rregullën zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. Si dëshmi për pretendimet e tona i kemi bashkangjitur ankesës fotografitë në cilësi të provës materiale.

Në përgjigje në ankesë të datës 29.09.2019, subjekti politik PDK, konsideron se shkelja nuk është në kundërshtim me LZP, pasi që vendosja është bërë me Pëlqimin e Komunës së Fushë Kosovës, për vendosjen e tendës në sheshë dhe shfrytëzimin e hapësirës publike. Si provë ne mbështetje të pretendimeve ne përgjigje ka bashkangjitur Pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike e Komunës së Fushë Kosovës për shfrytëzimin e sipërfaqës publike.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi dhe vlerësimit të shkresave në lëndë vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se materialet zgjedhore-posterat e kandidatit nga radhët e subjektit politik PDK, janë të vendosur në hapësirat publike-rrugë, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Këtë shkelje subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), nuk e ka pranuar në përgjigjen në ankesë të datës 29.09.2019.

Paneli, vendimin e tij e ka mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim në meritat e lëndës.

Parashtrimet në përgjigje në ankesë, se veprimet e subjektit politik PDK, nuk mund të sanksionohen si shkelje të LZP-së, për arsye se vendosja e tendës në shesh dhe shfrytëzimin e hapësirës publike, është bërë me pëlqimin e Komunës së Fushë Kosovës, nga data 27.09.2019 deri me 04.10.2019. Paneli pretendimet e tilla i vlerësoj si të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj pasi që, me këto prova nuk justifikon veprimet që janë të ndaluara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të Nenit 33 pika b) i LZP-së, si dhe neni 5 paragrafi 1 pika d) e Rregullës 13/2013, ku parashihet se subjektet e certifikuara politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t'i bëjnë në pajtueshmëri me Rregullat zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), dhe ndonjë legjislacion tjetër në fuqi. Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli me rastin e vendosjes se gjohës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së PDK-ja, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marra subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur më fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka mohuar shkeljet e supozuara. Mos ndërmarrja e masave përmirësuese ka ndikuar në lartësinë e gjohës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi .

Paneli konform nenit 120.1 pika a) të LZP-së urdhëroi subjektin politik PDK që të marrë masa dhe të përmirësoj shkeljet në afatin prej 24 orëve dhe nëse subjekti politik PDK, nuk

vepron sipas urdhrit të panelit do të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i , në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi..

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr.125/2019 më datën 30.09.2019

Kryesuese e Panelit
Gyltëne Sylejmani



***Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.*